

PLATFORMË

Tiranë, më 02 shtator 2021

Të nderuar kolegë,

Së pari, dua të pohoj se hyj tek ata prokurorë që, së bashku me shumë kolegë të mi të nderuar, e kam patur bindje dhe mbështetur fort parimin e pavarësisë së prokurorit dhe të zhvillimit normal e meritokratik të karrierës, sepse i kam konsideruar si faktorë të rëndësishëm që krijojnë premisa të mira, jo vetëm për rritjen e integritetit të prokurorëve por dhe që natyrshëm ndikojnë në një funksionim më të mirë të sitemit të prokurorisë.

Sot, 5 vite nga miratimi i ndryshimeve kushtetuese dhe ligjeve të tjera në kuadër të reformës në drejtësi të cilat kanë sanksionuar këto parime, kemi një sistem prokurorie të decentralizuar dhe prej 3 vitesh është krijuar një organ i ri që qeveris këtë sistem (Këshilli i Lartë i Prokurorisë), organ ky që në thelb vendos për karrierën e prokurorëve.

Mirëpo, decentralizimi dhe dhënia e pavarësisë së plotë një prokurori në ushtrimin e kompetencave të tij kushtetuese e ligjore nuk mund të kuptohet ndryshe, nëse këto ndryshime ligjore nuk shoqërohen me rritje të përgjegjësisë e të përgjegjshmërisë së vetë prokurorëve në kryerjen e detyrës, si dhe natyrisht, shoqëruar me llogaridhënie. Kjo diktoi nevojën e ri-dimensionimit të sitemit të Prokurorisë për ta çliruar atë nga korrupsioni e paafësia. Po ashtu, edhe për sa u takon aspekteve që kanë të bëjnë me karrierën e prokurorit, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nga një organ këshillimor pranë Prokurorit të Përgjithshëm iu dhanë kompetenca vendimmarrëse, duke krijuar kështu një organ tërësisht të pavarur.

Institucioneve të reja, ku bën pjesë edhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), nuk u mbetet tjetër veçse të jetësojnë atë konceptim të legjislatorit shqiptar, për instalimin e mekanizmave të efektshëm të garantimit të pavarësisë së prokurorëve, të llogaridhënies, të atyre që garantojnë zhvillimin meritokratik të karrierës, si dhe mirëfunksionimin e organeve të drejtësisë.

Në rrugëtimin pothuaj 3-vjeçar, KLP-së i është dashur të ndeshet me shumë sfida, duke nisur me krijimin, strukturimin, rekrutimin e punonjësve, infrastrukturën, krijimin e komisioneve, hartimin e akteve normative të organizimit dhe strukturimit të tyre etj., për të mundësuar funksionimin normal të këtij Këshilli. Të gjitha këto, natyrisht, kërkojnë një kohë jo të shkurtër.

Emergjente në fillimet e punës së KLP-së ishte edhe krijimi i Prokurorisë së Posaçme, emërimi i prokurorëve për të mundësuar funksionimin, krijimi i rregullave për të mundësuar emërimin e Prokurorit të Përgjithshëm etj..

Por, veç sfidave prioritare në aktivitetin e tij, Këshillit të Lartë të Prokurorisë i është dashur të përballë edhe sfida të tjera, të cilat lidhen me efektet e drejtpërdrejta apo anësore të shkaktuara nga procesi i vetting–ut, së pari tek vetë Këshilli. Më pas, në Prokuroritë e të gjitha niveleve, ku përqindja e lartë e të larguarve nga sistemi ka ndikuar, si në aspektin e mbingarkesës në punë, ashtu edhe në aspektin psikologjik të prokurorëve. Një numër i konsiderueshëm i tyre janë ende në pritje të përballjes me këtë proces. Pa dashur të devijoj prezantimin, lidhur me këta të fundit, gjej rastin t’i falënderoj për forcën dhe kurajën që gjejnë brenda vetes për të kryer me integritet detyrën si prokurorë.

Largimet nga sistemi i një pjese të prokurorëve, kanë shkaktuar jo pak probleme në mbarëvajtjen dhe aktivitetin e përditshëm në disa zyra prokurorie, të cilat, sipas rastit, kanë diktuar nevojën për caktimin e përkohshëm të prokurorëve në mënyrë që, nga njëra anë të garantohet në minimum drejtimi dhe funksionimi i këtyre zyrave, por nga ana tjetër, të mos cënohet rëndë dhe funksionimi i prokurorive nga ku janë deleguar këta prokurorë.

Kjo situatë natyrshëm ka patur nevojën e ndërhyrjes së KLP-së për të mbuluar vakancat e domosdoshme, por duhet theksuar e pranuar se ky proces jo gjithnjë ka qenë menaxhuar mbi procedura të normuara, transparente e mbi baza meritokratike.

Pavarësisht vështirësive, i qëndroj mendimit se KLP-ja nuk ka performuar në çdo vendimmarrje në lartësinë e detyrës. Dritëhijet në disa vendimmarrje, të cilat lidhen me karrierën e prokurorëve (*emërimet, caktimet e përkohshme në pozicione paralele apo funksione drejtuese*), kanë ndikuar më pas në perceptimin e prokurorëve për mënyrat dhe kriteret e përzgjedhjes së tyre, si pasojë e së cilës janë vënë në dyshim transparenca e procedurave të ndjekura për një përzgjedhje mbi baza të aftësive profesionale.

Si një vëzhgues me interes i këtij procesi, gjykoj se tregues të këtij perceptimi janë shfaqur në mungesën e interesit për t’u promovuar, si në ngritjet në detyrë (*për drejtues zyrash prokurorie ose nga shkalla e parë për në Apel*), qoftë këto edhe të përkohshme, apo edhe lëvizjet paralele nga një zyrë prokurorie në tjetrën. Kjo ka sjellë më pas faktin që KLP-ja ka vendosur në kushtet e mungesës së alternativave konkurruese lidhur me këto pozicione.

Mosmiratimi për një periudhë të gjatë i një Rregulloreje për ngritjen në detyrë dhe lëvizjet paralele të prokurorëve, si edhe disa vendimmarrje që lidhen me procesin e karrierës, të cilat kanë krijuar rezerva se nuk janë bazuar vetëm në rezultatet profesionale dhe integritetin e tyre, por të paracaktuara dhe nisur nga preferenca personale apo të ndryshme nga ato meritokratike, mendoj se kanë ndikuar jo pak në perceptimin e prokurorëve mbi organin e KLP-së dhe besueshmërinë e saj.

Ndaj, është koha të flasim e të këmbëngulim, madje më fort, për rritjen e integritetit të njerëzve të drejtësisë, për të dhënë drejtësi bazuar vetëm mbi Kushtetutë e ligj.

Duke marrë shkas nga mungesa e ambicieve në rangjet e prokurorëve për të bërë karrierë, - çka nuk është aspak shenjë pozitive, - mendoj se kjo duhet të na bëjë të reagojmë dhe reflektojmë gjatë, duke kërkuar nga KLP-ja të ngrihet në nivelin e përgjegjshmërisë që kërkon lartësia e detyrës, në kuptim e frymës që synoi të japë Reforma në Drejtësi. Kërkohet më shumë punë, më shumë energji e sakrificë për të rritur e rikthyer besueshmërinë, si edhe për të inkurajuar prokurorët të jenë më aktivë.

Sistemi i Drejtësisë në përgjithësi dhe gjithë organet e tij duhen parë si një makinë, e cila megjithëse ka disa sisteme të pavarura në vetvete (*sistem drejtimi, frenimi apo sinjalizimi etj.*) dhe ku secila prej tyre ka mekanizmat e saj me shumë pjesë përbërëse, duhet detyrimisht të ndërveprojnë për të ruajtur kohezionin dhe vënë në lëvizje mjetin, duke e bërë që, nga njëra anë të performojë sa më mirë dhe nga ana tjetër të mos krijojë probleme me funksionimin normal dhe natyrisht, të mos krijojë dëme.

Me këtë dua të them se, pavarësia e prokurorit apo institucioneve nuk është qëllim në vetvete por, nëpërmjet saj duhet të synohet mirëfunksionimi i të gjitha organeve dhe strukturave të sistemit të prokurorisë, i cili sigurohet vetëm në rast se ato, duke ndërvepruar mes tyre, krijojnë një sintoni dhe bëjnë që mekanizmat të funksionojnë normalisht për të përmbushur sa më mirë objektivat e sfidat që kanë përpara.

Në këtë drejtim ka ardhur koha për të gjetur mekanizmat e duhur për të ndërtuar një marrëdhënie të re mes KLP-së, vetë prokurorëve të Republikës dhe Prokurorit të Përgjithshëm, me një qasje interaktive të vazhdueshme për të siguruar kohezionin mes tyre, bazuar në frymën e besimit dhe ligjshmërisë, si dhe tek meritokracia, transparenca dhe llogaridhënia.

Na duhet të mësojmë të ndërveprojmë dhe të mirë-koordinohemi, sepse të gjithë, e më shumë qytetarët, presin nga ne më shumë rezultate.

Për t'a përmbyllur, përtej modestisë, desha t'ju siguroj se, me integritetin që kam shfaqur gjatë aktivitetit tim profesional dhe profilin e prokurorit apo dhe të drejtuesit që kam krijuar gjatë eksperiencës time 28 vjeçare, (*15 prej të cilave në prokurorinë e shkallës së parë dhe 13 të tjera në Prokurorisë së Përgjithshme, ku në disa vite kam qenë pjesë e strukturave drejtuese të saj*), janë indikatorë të mjaftueshëm për të treguar se, me besimin që do të më jepni për t'ju përfaqësuar në këtë organ (KLP), do të jem një zë i fuqishëm dhe i dobishëm në mbrojtje të interesave të prokurorëve, të vetë sistemit të prokurorisë në përgjithësi, etj.

Ju faleminderit!

Me respekt,


Sokol STOJANI